



UNIVERSITETI I TETOVËS  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО  
UNIVERSITY OF TETOVO

№. J. Gj. 02-1755/1  
21.06  
Univeriteti i Tetovës  
Zgjedhjet e rektorit  
Rectorat, rr. Ilinden 10  
Pristepanica, Ilinden  
5500 Tetovo, Republika e Maqedonisë së Veriut

Në bazë të nenit 97 paragrafi (12) të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/18 dhe 178/21), nenit 101 paragrafi (2) pika 10 dhe 11 të Statutit të Universiteti i Tetovës, si dhe Udhëzuesit për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2023-2026, miratohet ky

**VENDIM**

**për caktimin e kandidatit të zgjedhur për rektor të Universitetit të Tetovës**

**Neni 1**

Në bazë të rezultateve të përmbledhura të dorëzuara të votimit të fshehtë të njësisve të Universitetit, rektor i Universitetit të Tetovës është zgjedhur prof. dr. Jusuf Zejneli, profesor ordinar në Fakultetin Juridik.

**Neni 2**

Mandati i rektorit të zgjedhur zgjat 3 (tre) vjet, gjegjësisht për periudhën 2023-2026.

**Neni 3**

Të drejtat dhe detyrimet e rektorit përcaktohen me Ligjin për arsimin e lartë, me Statutin e Universitetit të Tetovës dhe me akte të tjera të Universitetit të Tetovës.

**Neni 4**

Procesverbalit i komisionit universitar të zgjedhjeve për rezultatet e përmbledhura për zgjedhjen e rektorit është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi dhe kundër procesverbalit në përbërje të tij, në bazë të nenit 107 të Statutit të Universitetit të Tetovës, mund të parashtrohet kundërshtim në komisionin universitar të zgjedhjeve në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të tij në adresën elektronike: [kuz@unite.edu.mk](mailto:kuz@unite.edu.mk). Kundërshtimi duhet të jetë paraprakisht i arkivuar në arkivin e Universitetit.

**Kryetari i**

**komisionit universitar të zgjedhjeve**  
**prof. dr. Nderim Zeqiri**

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

